

# Hyrje\*

Fabio Maniscalco

Globalizimi i “zakoneve”, “tendencave” dhe “produkteve”, te vendosura nga lobe me influence, dhe nderhyrja arrogante e disa Fuqive, ne ceshtjet e politikese brendeshme te Shteteve te botes se trete, ekonomikisht dhe ushtarakisht me te dobta, jane disa nga shkaqet kryesore te perplasjeve ideologjike te tanishme dhe te ferkimeve midis kombesive dhe qyteterimeve te ndryshme, qe gjithnje e me shpesh bejne te kuptohen dhe/ose te perligjen “arsyet” e pales kundershtare.

Gjithashtu, koniuktura ekonomike qe prej disa vitesh ngadaleson rritjen e tregjeve perendimore dhe flukset e panderprera migratore, qe vijne nga zona krizash, pashmangshmerisht nxitin fenomenin e intolerances raciale dhe fetare. Ky fenomen perhap ne menyre shqetesuese, edhe, per shkak te paragjykimeve e te kundershtise ndaj “te ndryshmes”.

Shumat e caktuara te Komunitetit politik nderkombetar, te finalizuara per te rritur njohjen e ndihmes reciproke dhe, keshtu, respektin per etnine e tjetrit, feja dhe/ose kultura, kane qene te pafrutshme,, si per shumat e pakta te shperndara, ashtu edhe, sepse ndonjehere, jane subvencionuar projekte te diskutueshme dhe jo te pershtatshme per te promovuar ne menyre konkrete dialogun midis “popujve” dhe “kulturve” te ndryshme.

Eshte e qarte, se, si ne kontekstin aktual boteror, ne te cilin interesat ekonomike mbizoterojne mbi te drejtat njerezore e ne te cilat individualizmi imponohet mbi solidaritetin, shihet gjithnje e me pak nevoja e ruajtjes se pasurise kulturore - materiale dhe jomateriale - te kombeve, qe perfaqesojne identitetin e cdo njerit Rajon te botes dhe qe rrezikohen te zhduken jo vetem per shkak te luftrave, te fatkeqesive natyrore o moskujdesit, por edhe per shkak te harreses se idiomave dhe te traditave popullore.

Nuk mendoj se eshte e mundur t’u transmetohen brezave te ardhshem keto ndjenja te tmerit, te paqartesis dhe te



1. Stari Most e rindertuar pas bombardimeve te vitit 1993.

pamundesise se provuar nga kush ka marre pjese ne shkaterimin e pabese te monumenteve unike, si ura e Mostarit, Biblioteka e Sarajeves ose Buddha e Bamiyan.

\* Traduzione – Translation: dr. prof. Adrian Anastasi.




2. Sarajeve. Bibloteka Kombetare dhe Universitare.

Gjithashtu, do të jete e veshtire të pershkruehen perceptimet e ndjera nga kush ka patur mundesine të vizitoje kishat shume të pasura serbo-ortodoske, të vandalizuara, të marra flake dhe/ose të minuara nga ekstremistet kosovare-shqiptare ose të riprodhoje ngjyrat, dritehijet ose kryeveprat e vecanta të gjenise njerezore, si Adhurimi i barinjve me Shenjtet Francesco e Lorenzo të Karavaxhos, të cilat asnje riprodhim fotografik o digjital mund t'u nxjerre ne pah saktesisht meritat.

Te shumta jane të mirat e kultures që, cdo dite, i humbim prej shkujdesjes, prej papershtatshmerise se ligjeve, per abuzivizmin ndertimor, shpesh i ndihmuar nga ligjerimet e papritura që ben shteti, per konfliktet dhe/ose per katastrofat e shkaktuara nga njeriu ose natura.

Eshte i pallogaritshem numri i objekteve arkeologjike dhe demo-etno-antropologjike të grabitura ne zonat jo të zhvilluara të botes, por të pasura me histori e kulture.

Zhdukja e memorjes historike nderkombetare eshte nje fenomen rreth të cilit opinioni publik dhe shtypi terheqin vemendjen teper rralle; ajo favorizohet nga mungesa, ne rendin juridik nderkombetar, të nje Organi, me nje rol të



3. Bamiyan. Rrenojat e njeres prej skulpturave madheshtore të Budes.



4. Caravaggio, *Adhurimi i pastoreve me Shenjtet Francesk dhe Lorenc.*

vendosur nga e drejta nderkombetare, ne gjendje qe te promovojë, aprovojë, shperndajë dhe te vere ne zbatim normat e perbashketa dhe me vecori gjeneralitetin dhe universalitetin.

Per momentin i vetmi organizem i posatshem per ruajtjen e te mirave kulturore, UNESCO, eshte pa pushtet real dhe, mbi te gjitha, gjate viteve te fundit ka humbur autoritetin e saj per paaftesine dhe per pertesen e treguar ne administrimin e disa rasteve krizash.

Ne 1996, me iniciativen e UNESCO-s dhe te kater OJQ-ve ne sektorin e pasurise (ICOM, ICOMOS, ICA e IFLA), eshte ngritur *International Committee of the Blue Shield* - Komiteti Ndrekombetar i Mburojes Blu (ICBS). L'ICBS, me deklaraten e saj "*Radenci*" (16 nentor 1998), ka shtruar objektivin te

ndertoje nje strukture shume te holle te vene ne pune per te shmangur humbjen ose shkaterimin e pasurise kulturore ne gjendje alarmi. Fatkeqesisht, megjithe deshiren e mire dhe dedikimin e disave, dhe krijimi i ICBS ka dale huq. Fatmiresisht, jane te shumte studuesit dhe subjektet qe ndjekin me sukses projekte, teorie e praktike, te mbrojtjes dhe vleresimit te pasurise kulturore. Atyre, qe shpesh, nuk u eshte dhene mundesia te perhapin rezultatet e tyre te kerkimit, as te perballen me specialiste te sektoreve te disiplinave te tjera, u eshte kushtuar "*Web Journal on Cultural Patrimony*" - "Gazeta Web mbi Trashegimnine Kulturore" qe ka si qellim te perqase nepermjet nje afrimi nderdisiplinor, raste te reja reflektimi dhe studimi me qellim gjetjen e metodologjive, teknologjive dhe instrumentave me te afta per ruajtjen e te Mirave kulturore.

I vendosur nen mbrojtjen e universiteteve me ne ze dhe qendrave nderkombetare te kerkimit dhe e realizuar fale kontributit te "*Osservatorio Euromediterraneo e del Mar Nero*" dhe me mikpritjen e Universitetit te Studimeve te Napolit "*L'Orientale*", kjo reviste shperndahet falas nepermjet internetit, nje mjet i cmuar qe do te garantoje perftesen e "*Web Journal on Cultural Patrimony*" dhe te nje publiku aq shume te gjere ne krahasim me rrethin e ngushte te specialisteve.



5. Irán. Bam mbas termetit te fuqishem te vitit 2003.